



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 494/2 Prot.

Tiranë, më 26 / 4 / 2018

V E N D I M

Nr. 110, Datë 26 / 4 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 44, datë 10.04.2018, të paraqitur nga shtetasi L.M kundër IEVP Peqin në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga L.M, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaron se: *“Në datë 10.03.2018 është transferuar nga IEVP Fier në IEVP Peqin. Në përfundim të procedurës së pranimit, i dënuari ka konstatuar që i mungonin, karta e bankës BKT, ora e dorës dhe një këpucë. Menjëherë i ka kërkuar P.R.B-s Ç.M i cili ka qenë në shërbim të njoftonte specialistin e trupës dhe oficerin e informacionit që të merrnin kontakt me të, por askush nuk e ka takuar. Në datë 12.03.2018 ka marrë kontakt me specialistin e edukimit të cilën e ka informuar për ngjarjen. Në datë 13.03.2018 ka parashtruar ankesën e tij inspektorit të Sh.K.B.B dhe Shefit të Regjimit të Brendshëm. Në datë 15.03.2018 ka takuar Specialistin e Edukimit, e cila me ton agresiv është munduar që të jepte shpjegime mbi ankesën e bërë nga i dënuari. Me datë 16.03.2018 ka dalë tek Komisioni Disiplinor të cilët nuk e kanë lejuar që të shprehte mendimin e tij dhe nuk ka firmosur vendimin e masës disiplinore me arsyen se nuk e shikonte të drejtë, por procesverbali është nënshkruar nga juristi i institucionit. Në datë 27.03.2018 ka dorëzuar tek specialistja kërkesë drejtuar Drejtorit të IEVP me objekt “Kthim përgjigje” dhe “Zgjidhje të ankesës së datës 10.03.2018”, kërkesa për të cilat nuk ka marrë asnjë përgjigje. L.M shprehet se Shefi i Policisë, B.K e paragjykon për shkak të veprës penale, duke e diskriminuar në çdo formë, duke i lënë porosi personelit të shërbimit që të mos e lënë të flasë në telefon me institucionet e Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të*

ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkaket e parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur indicie, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesi lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “gjendjes shoqërore”, shprehet se arsyeja është se: *“paragjykohet për shkak të veprës penale për të cilën është dënuar”*, Komisioneri, nuk e gjen të bazuar në ligj si një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” pasi të gjithë personat që vuajnë dënimin pranë IEVP Peqin janë të dënuar dhe në të njëjtën gjendje shoqërore si subjekti ankues.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me trajtimin në mënyrë më pak të favorshme, në raport me ligjin, por nuk ka paraqitur prova apo informacion për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mostrajtimi i ankesës në lidhje me pretendimin për humbje të materialeve të tija personale, dhënia e masës së dënimit dhe paragjykimi nga ana e personelit të institucionit është bërë për shkak të gjendjes arsimore dhe shoqërore të ankuesit.

Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në nenin 31/1, parashikon që: *“Avokati i Popullit ushtron funksionet e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar organizohet dhe funksionon si seksion i veçantë i Avokatit të Popullit”*.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, shtetasi L.M mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme e të parregullta të personelit të IEVP Peqin, por nuk përbën trajtim diskriminues në raport me të dënuarit e tjerë. Duke qenë se institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë të shqyrtojë veprimet ose mosveprimet e paligjshme, rekomandon ankuesin që t’i drejtohet institucionit të Avokatit të Popullit, si një organ i cili ka në funksion të detyrës së tij trajtimin e rasteve në fjalë.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit L.M, për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI